

VENDIM
Nr.525, datë 8.7.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.96, DATË 24.2.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E TË PUNËSUARVE TË PORTIT DETAR Durrës, TË
CILËT DALIN TË PAPUNË SI PASOJË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË
RISTRUKTURIMIT TË KËTIJ PORTI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.96, datë 24.2.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Të punësuarit në Autoritetin Portual Durrës, të cilët dalin të papunë si pasojë e rristrukturimit dhe proceseve të privatizimit të sektorëve të ndryshëm të këtij porti, përfitojnë të drejtën e pagesës për një periudhë njëvjeçare, në masën 100 për qind të pagesës mesatare mujore, të vitit të fundit të punës, por jo më pak se paga minimale, në shkallë vendi, në çastin e shkëputjes nga puna.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Përfitojnë nga ky vendim të punësuarit në Autoritetin Portual Durrës, të cilët kanë qenë të punësuar në këtë Autoritet pa ndërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 1 (një) vit dhe vazhdojnë të jenë të punësuar në këtë Autoritet nga data 15.4.2005 deri më 21.10.2006.”.

c) Në pikën 4, emërtimi “Autoriteti Portual Durrës sh.a.” zëvendësohet me “Autoriteti Portual Durrës”.

ç) Në pikën 7, fjalët “...Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe Ministria e Transportit...”, zëvendësohen me “....Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano